




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL II/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 2 (dytë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.02.2025
Ora: 10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci

Z.Selman Kolgeci

Z. Flamur Bytyçi

Z. Urim Suka

Z. Kushtrim Kuçi

Znj. Elmaze Bytyqi

Znj. Bulëza Kuçi

Znj.Doruntina Zenelaj

Z.Alban Berisha

Z. Bexhet Kuçi

Z. Reshat Selimaj

Z. Lirim Qatani

Z. Aziz Bytyqi

Znj.Sanie Kuçi-

Rexhepaj

Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina

Z. Vullnet Luzhnica

Z. Xhevshet Gashi

Z.Edon Sadikaj

Znj.Saranda

Bajraktari

Znj.Mimoza Bajraktari

Znj.Festë Kabashi

Z.Dardan Berisha

Z.Bajram Basha

Znj.Mevlude Kabashi

Znj.Sheqerije Zyrapi

Znj.Laureta Tafaj

Z.Liridon Fandaj

Z.Qëndrim Elshani

Z.Herolind Limaj

Znj.Jehona Lumi

Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

**Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-lokalet;

3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-Panot reklamuese;

4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38),Granti Qeveritar - Rezervat për vitin fiskal 2025 në projektin kapital;

5.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës;

6.Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2024;

7.Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;

8.Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - kemi kërkesë nga Drejtoria e Pronës për një pikë shtesë.Fjalën e ka Drejtori i Pronës.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit.Sa i përket pikës shtesë ministria e ka kthyer vlerësimin dhe ka vlerësuar që çdo gjë është në rregull dhe të dy vlerat i ka caktuar të njëjta.Këtu është gjithçka në rregull dhe i ka kaluar komplet procedurat herën e kaluar dhe për mos me zgjat edhe një muaj tjetër është mirë të futet si pikë e rendit të ditës.

Urim Suka - nuk e pata të qartë sqarimin e drejtorit por nëse mundet drejtori me na dhënë sqarime edhe një herë se për çfarë prone bëhet fjalë dhe cili është interesi i komunës.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit.Dua ti them drejtorit se jo çdo herë kur ti thua që është në rregull,ka me qenë në rregull andaj ne kërkojmë kohë me shqyrtu dhe me vendos nëse do ta votojmë.

Armend Krasniqi - bëhet fjalë për hapjen e rrugës „Vudro Willson „ në rrugën„Aleksandër Moisiu“.Pra,për shkak të kërkesave të Urbanizmit për me rregullu parcelën dhe me inkuadru një rrugë të cilën e kemi pas në Harta Zonale,ne e kemi fillu një iniciativë për një hapje të rrugës e cila është në interes të komunës dhe në kuadër të kësaj iniciative ne e kemi kaluar fazën e parë dhe këtë fazë e ka pranuar ministria.Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - unë po e kuptoj pak a shumë ngjarjen dhe e di interesin e përgjithshëm deri diku por ne e kemi një letër që na ka ardhë dhe aty nuk shkruan projekt-vendim dhe unë nuk e di se çfarë vendimi kemi marrë ne dhe nëse mundeni këtë pjesë me specifiku.

Kryesuesi - plotësisht pajtohem me ty sepse dokumenti që na erdhi sot,lënda po shkruan njoftim dhe duhet të marrim një mendim nga zyrtari ligjor.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit.Me sa kuptova unë,vendimin dhe diskutimin që e kemi pas në seancën e kaluar pothuaj e kemi hargju dhe diskutu në përpikmëri.Ky vendim që i ka shku ministrisë prej Kuvendit dhe ministria e ka kthyer pozitive dhe për mos me prit një muaj,besoj që drejtori e arsyetoi vendimin e tij dhe realisht i njëjti vendim ka me na ardhë seancën e rregullt dhe nëse vjen, i bjen që ne me diskutu ende për këtë vendim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - nuk po shoh që ka urgjencë për me u inkuadru kjo pikë jashtë rendit të ditës për arsye se u diskutu në mbledhjen që veç e kemi inicuar si procedurë që ky bllok ndërtimor nuk është i

pastruar nga parcelat e tjera. Nëse ka zgjidhje të tjera që ju i keni zgjidh ato problematika që kanë qenë në pronat publike dhe private, na jep si informacion dhe nëse pala mundet menjëherë me vazhdu për aplikim për kushte dhe leje ndërtimore, atëherë mundemi me shty përpara si pikë e rendit të ditë.

Armend Krasniqi - e nderuar asambleiste ke interpretu komplet një procedurë të një lënde tjetër. Këtu bëhet fjalë për një pikë tjetër të rendit të ditës që e kemi kaluar dhe është i rregulluar komplet blloku ndërtimor dhe me një procedurë mundet me u dhënë leja.

Sanie Kuçi Rexhepaj - faleminderit por unë nuk e pata një letër përpara dhe me aq sa sqarove për neve nuk ke qenë plotësisht i qartë dhe nëse është mundësia me dhënë sqarime më shumë ose ndonjë skicë nëse ke me na dorzu secilit.

Alban Berisha - drejtor pajtohem me dokumentin por nuk po e kuptoj kërkesën tënde. A është plotësim-ndryshim i vendimit, a është vendim i ri? Sepse me ardhë një njoftim dhe me kërku prej neve me votu, këtë s'po e kuptoj. Nëse është vetëm njoftim s'ke nevojë me fut në rend dite. Kërkoj ta sqarosh kërkesën tënde se pse me fut në rend dite.

Armend Krasniqi - ligji për dhënie në shfrytëzim të pronave dhe këmbim të pronave thotë që së pari duhet të merret iniciativa për me inicu një procedurë e cila është në interes të Komunës, mandej bëhet ligjshmëria nga ministria dhe pas ligjshmërisë nga ministria shkon vendimi në ministri për vlerësimin e pronave dhe aty bëhet vlerësimi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Pas këtij vlerësimi e ka obligative komuna që me votu. Drejtori tutje jep sqarime.

Alban Berisha - këtu po shkruan njoftim dhe sa e di njoftimi nuk votohet por vetëm informohemi. Unë nuk po them që është keq ose mirë por si dokumnet pse ka nevojë me hy në rend dite.

Armen Krasniqi - duke u bazuar në ligjet kompetente të cilat i kanë inicu me procedura të rregullta, njëra nga pikat e kërkon edhe këtë njoftim për me votu në Asamble.

Selman Kolgeci - e kemi në fuqi një vendim që e kemi nxerr në nëntor ose dhjetor për të njejtën çështje dhe jemi pajtu atëherë që është e nevojshme me hap rrugë aty dhe investime sipas HZK-së. A ka me mbet ai vendim në fuqi nëse sot po dojmë diçka tjetër apo kemi me bë plotësim-ndryshimin e atij vendimi? Kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor, a duhet plotësim-ndryshim i atij vendimi apo duhet vetëm njoftim i këtij dokumenti që ka ardhë prej ministrisë? Po e shoh një vlerësim që është bë prej ekspertave të Ministrisë së Financave dhe nuk kam çka me shtu te vlerësimi sepse ata janë eksperta.

Avni Bytyqi - realisht edhe unë tash u njoftova sikurse ju për këtë çështje. Deri në këtë fazë në aspektin ligjor mendoj që jemi në rregull mirëpo para se të merret vendimi kërkohet një varg dokumentash të plotësohen para se ky vendim të merret sot. Njëri prej vendimeve kryesore që e kërkon ligji dhe rregullorja është vendimi për shpalljen e interesit të përgjithshëm gjë të cilën ne e kemi marrë ndërsa dokumentat tjera unë personalisht nuk i kam pa. Përpos vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm janë edhe 8 dokumente tjera që duhet të plotësohen nga komuna dhe atëherë duhet të vjen në Kuvend që të miratohet ai vlerësim dhe ato dokumente të cilat i ka prezantuar komuna. Albani pat të drejtë që tha: para vete duhet ta kemi projekt-vendimin për këmbimin e pronës publike me pronën private, për të cilën nuk kemi mujt me përgadit sepse ne vetëm sa u njoftuam.

Armend Krasniqi - dokumentet që përmendi zyrtari ligjor, i kemi të rregullta dhe i kemi dorzu te Kryesuesi i Kuvendit.

Avni Bytyqi - unë nuk po i kontesoj dhe nëse i ke prezantoi.

Armend Krasniqi - i kemi pas seancën e kaluar dhe i kemi prezantuar.

Avni Bytyqi - nuk i ke pas në seancën e kaluar.

Urim Suka - përkundër vullnetit që ne e kemi për me kalu si lëndë dhe për deri sa është e papërgaditur dhe ne nuk e kemi projekt-vendimin përpara për çka do të votojmë, ne nuk mund ti japim mbështetje. Praktika të tilla nuk duhet të përsëriten dhe ju lus të vazhdojmë seancën dhe kjo lëndë le të përgaditet dhe le t'vje në një seancë të rregullt.

Alban Berisha - nëse është vendim, shko ndërroja emrin dhe jemi në rregull. Nuk ke pse me paraqit dokumenta sepse ti je kompetentë dhe je i thirrur për me i plotësu këto dhe besoj personalisht që ti i ke plotësu këto. Drejtor le të jetë hera e fundit që na vje njoftim ose informim me votu.

Kryesuesi - ne u njoftuam me këtë lëndë dhe e lëmë për seancën tjetër. E hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës.

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-lokalet;

Kryesuesi - e elaboron pikën 2 dhe hap debatin. Nuk ka debat, e hedh në votim pikën 2.

25 për, Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurta të pronës së paluajtshme të Komunës-Panot reklamuese;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon që të jepet për 15 vite. Hap debatin.

Qëndrim Elshani - përshëndet të pranishmit. Ju përgëzoj për iniciativën edhe pse e vonshme. Sa reklama do të vendosen në secilën prej rrugëve? Sa i përket punës së vitetve, mua dhe grupit parlamentar na duket shumë 15 vite dhe besoj një shifër më e vogël e viteteve do të ishte më e mirë për komunën e Suharekës.

Kryesuesi - në të kaluarën ka qenë 10 vite mirëpo tash është nga 1 deri 15 vite.

Armend Krasniqi - është e vërtetë që kontrata ka sakduar dhe nuk janë marrë iniciativa për dhënie në shfrytëzim ku kemi pas mospërpuethshmëri mes zyrës sonë dhe zyrës së urbanizmit se kush duhet me inicuar procedurën. Kemi ra në një pikë që procedurën duhet me inicuar ne. Sa i përket se sa reklama duhet me qenë, mendoj që ne duhet ta bëjmë një komision i cili do të përgadis shpalljen e ofertës që kanë me hap përmes ankandit publik dhe aty do të përcaktojnë se ku duhet të vendoset dhe çdo detaj tjetër.

Alban Berisha - ne si grup propozojmë që maksimumi i afatit për dhënie në shfrytëzim me qenë 5 vite. Nuk është që ka me pas një investim të madh kush do që e merr e që duhet patjetër me dhënë afatgjatë. E përgëzoj drejtorin për këtë propozim dhe në anën tjetër kërkoj nga drejtori që seancën e radhës ose në një seancë tjetër me na sjell një raport me shkrim rreth kontratës së kaluar. Në kontratën e kaluar, a kanë qenë krejt këto rrugë apo ka qenë vetëm „Brigada 123“ dhe a është shfrytëzuar konform kontratës së kaluar që ka qenë? Këto dy vite që ka skaduar kontrata, a ka gjeneruar komuna të ardhura dhe a është e ligjshme me gjeneruar të ardhura prej një kontrate inekzistente?

Armend Krasniqi - Në momentin që ka përfunduar kontrata, ne i kemi njoftuar Drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e Inspeksionit pastaj ata janë marrë me borxhe ndërsa inspeksioni nuk e ka lejuar që të vendoset asnjë reklamë në komunën e Suharekës. Operatori ekonomik ka borxhe mjaft të mëdha sepse nuk iu ka përmbajtur kontratës. Drejtori tutje jep sqarime.

Alban Berisha - unë nuk pyeta për operatorin se a i ka pagu borxhet apo jo por pyeta për këto 2 vite, a janë inkasuar paratë dhe nëse janë inkasuar, a ka qenë e ligjshme.

Armend Krasniqi - sa i përket kontratës të cilën e ka pas DSHPJK, drejtoria e ka respektuar kontratën në komplet pikat të cilat i ka parapara kontrata. Në momentin e skadimit të kontratës është njoftuar në Drejtorinë e Financave, D. Inspeksionit dhe zyrën e Kryetarit sepse është obligim ligjor dhe pastaj nuk merret më Drejtoria e Pronës nëse dikush shkon dhe e vendos paligjshëm por merret inspeksioni.

Urim Suka - ju keni lënë dikënd me funksionin 2 vite pasi i ka dalë kontrata dhe tash këtu folni me mburrje. Normal tash është mirë që po vjen por është tepër vonë dhe këtu dikush prej juve si pushtet duhet me dhënë llogari se pse ka mbetur kaq vonë. Panot reklamuese që ne tash do ta japim pëlqimin për me e c përpara, është fjala këtu 5 rrugë por ne shpeshherë kemi pa që përtej këtyre 5 rrugëve, pano reklamuese

vendosen edhe në rrugë tjera apo edhe në vendbanime e fshatra tjera. Përveq këtyre rrugëve që i keni parapa, a mundet specifikisht m'u kanë edhe një pikë plus që i parasheh edhe disa vendbanime tjera? Mendoj që kjo e kish rrit inkasimin ndoshta dhe do ti kishte leju mundësinë dikujt nëse don në këto vendbanime me bo një reklamë, me pas të drejtën ligjore me bo një gjë të tillë.

Armend Krasniqi - zanafilla e burimit të problemeve të pronave është zakonisht mas luftës. Pushteti i mbas luftës ka bërë kontrata që kurrë nuk më nuk i ka kontrollu ato kontrata. Kur kam ardhë unë jam mundu me i rregullu disa kontrata dhe kam bërë maksimumin. Problematika e pronës është një problematikë e madhe dhe nuk them që e ka bërë vetëm LDK-ja dhe me siguri edhe në qytetet tjera e ka bërë dikund PDK-ja dhe dikund AAK-ja. Ky problem nuk është që një vit ose dy por kjo ka bartje të problemeve prej viteve 60-ta, 70-ta andaj ne për këto probleme bashkarisht duhet me gjet zgjidhje dhe me i qu përpara.

Urim Suka - unë nuk fola për problemet që janë të grumbulluara, unë fola për projekt-vendimin. Drejtor, nuk është vullnet i drejtorit cilën lëndë me kry e cilën mos me kry por është detyrë ligjore e një drejtori, një ekzekutivi që secilës kontratë që i skadon afati duhet me vepru. Nëse unë kam qenë drejtor më herët dhe e kam bërë një gabim, kjo nuk e justifikon. Kush do që e ka bërë gabim, le ta mban faturën për gabimin që e ka bërë. I rekomandoj drejtorit që të gjitha kontratat që i ka, kur i afrohet afati i skadimit, le të veprojë në mënyrë të njejtë për të gjitha.

Armend Krasniqi - kontratat të cilat i kam obligim me i mbikqyrë, janë kontrata vetëm 1 vjeqare. Të gjitha kontratat të cilat i kam lidh janë të rregullune 100%. Kontratat të cilat lidhen mes 1 deri 15 vjet dhe 15 deri 99 vite janë kontrata të cilat duhet të menaxhohen nga Kryetar i Komunës.

Visar Kuçi - kontrata e parë që ka skadu ka qenë në të kluarën në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Pronës por sektori i pronës ka qenë në Drejtori të Urbanizmit dhe ky ka qenë problem se cila drejtori duhet me udhëheq. Sa i përket rrugëve materialin e ka përgadit Drejtoria e Urbanizmit dhe e kemi parapa në zonën urbane që të vendosen panot reklamuese. Sa i përket reklamava tjera unë mendoj që në këto 5 rrugë komisioni kur të caktohet prej Asamblesë, të jenë vendet e specifikuara se sa do të jenë në secilën rrugë kurse edhe sot mund të marrin reklama firmat tjera prej 1 ditë deri në 365 ditë ku mund të aplikojnë në Drejtorinë e Urbanizmit. Kjo rregullore është aprovuar nga ju vitin e kaluar dhe është me tarifa mujore.

Selman Kolgeci - rrugët rajonale dhe rruga nacionale që janë pronë e ministrisë, e di që një pjesë e tyre është zonë urbane, mos po na shkakton ndonjë problem për shkak se Ministria e Infrastrukturës e ka një udhëzim administrative të caktuar për pano reklamuese dhe mos po biem ndesh me ta dhe e kthejnë vendimin prapa? Dokumentet që i ka përgadit drejtoria e pash që këto janë brenda zonës urbane por do të ishte mirë me potencu edhe distancën. Çështje tjetër është edhe kriteret për vendosjen e panove që nuk është në këtë fazë por duhet ta keni parasysh për shkak se disa janë pengesa për zhvillimin e komunikacionit.

Kryetari - Urimi e bëri një pyetje por në bazë të HZK-së dhe PZHK-së e pjesës urbane e dine ku i vendosin sepse ne nuk kemi mundësi me vendos asnjë reklam prej Shirokës deri në Mushtisht ose rrugën e Reqanit sepse është pronë e ministrisë ose duhet me marrë leje ne si Komunë prej ministrisë për me dasht me vendos.

Selman Kolgeci - këtë që po thotë Kryetari, këto dy rrugë janë të specifikuar të cilat kanë me u shfrytëzu për reklamim. Është rruga "Sënderbeu" R 117 që është rrugë rajonale Xërxë-Rahovec-Suharekë dhe është R 118 që është rruga Suharekë-Mushtisht-Brezovicë. Mendoj që fillimisht është mirë me pas kërku një sqarim prej ministrisë se a na lejojnë me i vendos.

Visar Kuçi - edhe rruga "Brigada 123", rruga "Skënderbeu" dhe rruga për Mushtisht janë rrugë regjionale por janë në zonën urbane. Kemi pas kontakte me ministrinë dhe pas problemit me rrugën "Skënderbeu" kemi pas edhe raste tjera dhe i kemi dërgu kërkesë ministrisë dhe në këto rrugë menaxhojmë, karakteri i rrugëve nuk ndërrohet por menaxhimin e bën komuna. Në seancën tjetër kur të caktohet komisioni unë propozoj që në vendim të komisionit me pas edhe një pikë shtesë që lokacionet dhe llojet e reklamave të cekën për shkak se ky vendim nuk do të vje më në Asamble.

Dardan Berisha - ne si grup parlamentar i PDK-së kemi parsysh që çdo vit po ndryshojnë çmimet, inflacioni dhe me shku paralel kjo çështje, ne propozojmë për 5 vite me shku.

Qëndrim Elshani - sa i përket denimeve që e përmendi drejtori, më e keqja është që ju e keni ditë që jeni duke bërë shkelje dhe prap keni marrë denime. Sa i përket viteve ne si grup i LVV-së jemi pro 5 viteve të

dhënies në shfrytëzim të këtyre hapësirave.

Kryesuesi - në të kaluarën ka qenë 10 vite dhe mua më duket pak është 5 vite.

Alban Berisha - kanë qenë disa leda në ministacionet e autobusave, si janë menaxhu ato dhe a kanë pas të drejtë kompanitë private me reklamu aty? Apo kanë qenë të vendosne për me i shfrytëzu më shumë për foto të Kryetarit.

Visar Kuçi - operatori që i ka realizu këto punime e ka edhe fazën e mbikqyrjes dhe në momentin që i kalon faza e mbikqyrjes do të jepen në shfrytëzim ose do ti menaxhoj komuna.

Avni Bytyqi - Drejtoria e Urbanizmit në vitin 2019 ka hartu një plan për vendosjen e objekteve të përkohshme në komunën e Suharekës dhe ky Kuvend e ka miratu atë plan i cili ka qenë 5 vjeçar dhe konfirmimin e ligjshmërisë e ka marrë nga ministria e linjes dhe mbi bazën e planit komuna ka vepru dhe i ka vendos ato ministacione.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e ekzekutivit që hapsirat publike për pano reklamuese të jepen në shfrytëzim për 10 vite.

11 për, 12 kundër, 6 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin e dytë që hapsirat publike për pano reklamuese të jepen në shfrytëzim për 5 vite.

16 për, Miratohet pika 3 që hapësira publike të jepet në shfrytëzim për 5 vite për pano reklamuese

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar -Rezervat për vitin fiskal 2025 në projektin kapital;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Laureta Tafaj - këtu po shoh që po ri-alokohen mjete për blerjen e një auto fshese për pastrim të NPL “Eko Therandës”. Sa punëtor i ka “Eko Theranda” dhe a ka kush me punu?

Kryetari - këto mjete kanë kaluar në buxhet, shtator të vitit 2024-2025 dhe kompania është në formim e sipër. Në moment që bëhen paisjet ju e dini që është një plan që punëtorët e Eko Regjionit me një marrëveshje e kalojnë komplet kompaninë dhe vazhdojnë punën.

Laureta Tafaj - po blehet një aparaturë pa pas punëtor për me punu me të.

Urim Suka - të gjithë kemi qenë të gëzueshëm kur e ka marrë dritën jeshile Eko Theranda nga qeveria lart dhe përpjekja jonë ka qenë edhe atëherë me themelu, edhe në planin tonë të LDK-së ka qenë që me pas një kompaninë tonë që kryen disa shërbime që janë më afër qytetarit. Kjo kompani është në themelim e sipër dhe normal i nevojitet mbështetje financiare dhe ne i japim gjithë mbështetjen sepse këto pare nëse mbesin në rezerva sipas informatës që kam këto mbesin pa u shfrytëzu. Përgjigja e Kryetarit mu duk në stilin e papërgjegjshmërisë. Nuk e di a munden punëtorët prej atje me kalu këndej sepse i bie që me shujt njëra tjetrën dhe nuk mendoj që punëtorët kalojnë prej andej-këndej por duhet të shpallen konkurset dhe të ndiqen procedurat që edhe kjo kompani m’i pas punëtorët e vet dhe kompania tjetër i ka shërbime tjera që duhet m’i kry. Kjo na jep një lloj shqetësimi për mënyrën si ka me funksionu pastaj edhe Eko Regjioni me këtë menaxhim që e keni.

Kryetari - ne jemi aksionar në kompaninë e “Eko Regjionit” 13%. Të gjitha paisjet që kanë ardhë janë në vlerë 800.000€ dhe janë regjistru në emër të komunës. Është duke punu bordi, krijohen kushtet dhe me një vendim e bëjmë ndarjen dhe kalojnë në menaxhim të komunës Eko Regjioni. Kryetari tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

20 për, 1 kundër, Miratohet Pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Nuk ka debat, e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i raportit vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2024;

Kryesuesi - hap debatin për pikën 6.

Bulëza Kuçi - përshëndet të pranishmit. Sipas mendimit tim dhe sipas mundit që kam mund ta shtjelloj te kjo pjesë, unë kam pa disa defekte që i kam identifikuar. Mungesa e qartësisë dhe strukturës është e lartë, p.sh. ndarja sipas llojit të kontratave, sektoreve, vlerave të kontratave është jo e qartë. Informacioni i paqartë ose i munguar, p.sh. për disa kontrata mungon emri i operatorit ekonomik ose janë të paspecifikuara burimet financiare, nuk ka një analizë të hollësishme të ekzekutimit të kontratave ose janë të realizuara jo në afatet e kërkuara, disa data janë të paqarta dhe ka raste kur data e përfundimit të kontratës është para fillimit të saj. Disa kontrata kanë vlera të ndryshme të parashikuara dhe të kontraktuara, në disa raste shuma e aneks kontratave është shumë e lartë krahasuar me kontratën bazë, nuk ka një analizë të ofertave të refuzuara, mungojnë informacionet për penalitetin ndaj operatorëve të cilët nuk i kanë përmbushur obligimet, nuk tregohet konkurrenca në tendere, sa kompani kanë aplikuar dhe sa janë përzgjedhur.

Selman Kolgeci - është hera e katërt që ne e marrim një raport për kontratat e nënshkruara dhe këtu nuk e kemi menaxherin e zyrës së prokurimit i cili është dasht të vijë dhe të raportojë. A ka pas vonesa në projekte? Si janë realizuar? A ka pas apo jo pengesa? Ne po shohim kontrata që nuk kemi kontrata vetëm me kriterin çmimi më i lirë por kemi kontrata që janë lidh me kriterin tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm. A ju ka bërë e pa drejtë dikujt tjetër? Për shkak se nëse thua që i kryen disa punë për 15 ditë dhe nuk ke mundur ti kryesh për 9 muaj, kjo nuk është në rregull sepse është padrejtësi ndaj operatorit tjetër që e ka ofruar një çmim pak më të shtrenjtë por e ka ofruar një plan dinamik më të gjatë. Kjo formë e raportimit nuk është në rregull dhe mendoj që nuk duhet të kalojë kështu edhe pse e di që nuk kemi me votu. Po shoh kontratë për qentë endacak dhe sipas letrave po del që ky projekt në vlerë 20.000€ është kryer. E di që është e pamjaftueshme me i trajtuar qentë por dua ta di se çka u bërë me 20.000€? Këtu kemi propozuar për ta bërë një zgjidhje çoftë afatgjatë, çoftë të përkohshme për shkak se janë cenim për të gjithë ne. Pash dhe një projekt tjetër i cili është: ndërtimi i një ministacioni policor dhe ndërtimi i një ministacioni të zjarrëfikësive dhe më intereson se çka ka ndodhur. A kemi nevojë ne dhe a kemi të drejtë ne me ndërtuar një ministacion policor? A ka bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme? Është mirë të sqaroni edhe çështjen e urave dhe kërkoj prej drejtorit nëse ka qenë menaxher ose kush do që ka qenë, të sillni një raport se sa ura janë ndërtuar në 4 vitet e shkuara dhe në cilat kontrata janë ndërtuar këto ura.

Kryesuesi - me zyrtarin e prokurimit jemi dakordur dhe do të vinte por në moment e kanë ftuar auditorët.

Urim Suka - kur jemi te vendimet që neve na vinë, ekzekutivi duhet të jetë serioz sepse këtu po folim për dokumente zyrtare. Te raporti i kontratave edhe vitin e kaluar kemi dhënë vërejtje të mospërputhjet e kontratave me vlerat që figurojnë këtu por sqarime nuk kemi marrë. Kur jemi te raporti i kontratave, këto kontrata duhet me reflektuar atë që ka ndodhur gjatë vitit 2024. Unë do të jap disa informata që për mua janë të paqarta. P.sh. në këtë raport figuron që ju keni nënshkruar një kontratë në vlerë rreth 264.000€ për ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza në Sllapuzhan. Në bazë të raportit që keni në kontratë kjo nuk është pagu dhe kjo nënkupton që nuk është realizuar në teren. Nëse nuk është realizuar, pse nuk është realizuar? Ku kanë shkuar këto mjete? Kontrata tjetër për Greiqec është: vazhdimi i rrugës “I Seferi, Dy Martirët, Veterani” në Greiqec ku sipas kësaj kontrate figuron që këto rrugë janë shtruar dhe janë pagu mirëpo me informatat që i kam marrë më herët, unë e di që rruga “I Seferi” nuk ka vazhduar, rruga “Dy Martirët” nuk është shtruar por është shtruar një rrugë tjetër atje. Pastaj në buxhetin e miratuar për vitin 2024 kanë qenë të planifikuara 80.000€ për ndërtimin e rrugëve lokale: degëzimi i rrugës “Agron Berisha, Çajupi, Xhavit Sylas-segment, Zek Bajraktari-segment” dhe kur e lexova raportin askund nuk pash që është bërë një kontratë për ndërtimin e këtyre rrugëve. Nëse nuk ka kontratë, ku kanë shkuar 80.000€? Këto tre elemente që unë po i jap janë vetëm tri çështje që në këtë raport të kontratave ka plot të tilla. Pres përgjigje për temat që i ngrita dhe pres që raporti i kontratave çdo vit tjetër të mos na vijë kaq keq i përgaditur dhe kaq pak sqarime.

Visar Kuçi - janë hartuar projekte dhe nuk është impianti vetëm në Sllapuzhan, është edhe në Dubravë. Janë pilot projekte dhe është hartuar projekti, janë adresuar të shërbimet publike dhe shërbimet publike i kanë udhëhequr procedurat dhe sa e di është nënshkruar kontrata.

Enver Shabani - përshëndet të pranishmit. Kontratat në Suharekë që përmendet për rrugët Zef Bajraktari,

Xhavit Sylja etj, ju e dini që vitin e kaluar kemi pas probleme me përmbaruesin për pjesën dërmuese të parave që e kanë marrë ata, rreth 4.3 milion dhe procedurat për projektin e paraparë për Suharekën nuk janë zhvillu fare andaj nuk ka pas as kontratë dhe nuk kanë përfunduar rrugët lokale në qytetin e Suharekës. Sa i përket impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në fshatin Sllapuzhan, është e vërtetë që kemi inicuar një procedurë dhe e kemi udhëheq bashkë me zyrën e prokurimit. Ata e kanë nënshkruar një kontratë me një operator por problemet kanë dalë në teren sepse sipas projektit detaj impianti i ujërave të zeza është parapara të ndërtohet në një parcelë private dhe marrëveshja me pronarin e parcelës ka qenë vetëm gojore dhe jo me shkrim. Andaj punimet janë pezullu për kohësisht. Drejtori tutje jep sqarime. Në Dubravë nuk kemi probleme me parcelën por kemi disa ankesa dhe punët nuk kanë filluar ende. Sa i përket rrugëve të Greiqecit, mjetet janë shpenzuar, metrat katror janë shtruar dhe nuk janë qind për qind ato rrugë që theksohet por katër rrugë janë shtruar dhe ka përfunduar si kontratë. Secila kontratë kur të përfundon e ka një raport detaj dhe ju mund të merrni secilin raport për secilën kontratë sepse menaxheri i kontratës është i obliguar me të një raport përfundimtar, çoftë për vonesat, çoftë për planin dinamik dhe për realizim ose jo realizim. Sa i përket ndëshkimeve kemi rastet që i kemi ndëshku.

Urim Suka - ajo që mua më shqetëson, p.sh. rrugët që përmenda unë në Suharekë kanë qenë të planifikuara dhe nuk është bërë kontratë për me u shtruar ato për shkak që përmbaruesi i ka marrë partë por për vitin e ardhshëm këto rrugë nuk figurojnë askund në vitin 2025. Te pjesa e impianteve 264.000€, përmende shumë arsye pse s'ka ndodhur investimi dhe e di që planifikimi dhe investimi mund të kenë probleme. Pyetja ime ishte se 264.000€ ku ka shkuar janë suficient? Te Greiqeci drejtori tha janë shtruar 4 rrugë kurse unë fola për rrugët që ty në raport po të figurojnë, që këto rrugë janë të shtruar dhe sipas informatave që kam, këto rrugë nuk janë të shtruar dhe kjo është shqetësim. Juve si ekzekutiv ju takon me i shtruar ato rrugë që janë miratuar në Asamblenë ndërsa ju i keni ndryshuar ato, i keni devijuar dhe me sa unë e di ju nuk keni të drejtë me i ndryshuar krejt, mundet me dalë me një rrugë një problem dhe e ndryshon me një vendim por të gjitha rrugët me ndryshuar, kjo është gabim.

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit financiar të ekzekutimit dhe administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Laureta Tafaj - te pjesa e sasisë të gjitha e kanë sasinë 1 por nëse flasim për furnizim me veshmbathje për zyrtarët e drejtorisë dhe zjarrëfikësive, nuk dyshoj që veshmbathjet e tyre mund të kushtojnë 2500€ edhe për një person por nëse thuhet për drejtorin dhe shifra është 1 atëherë nuk po përputhet. Furnizim me pajisje kompjuterike - sasia 1 - 3200€, edhe nëse është një kompjuter ose disa pajisje, kjo është e paqartë. Furnizim me buqeta me lule - sasia 1 - 3000€. Tjetër është trajtimi i qenve endacak - 30.000€ por çfarë masa do të ndërmirren me këtë? Apo sikur praktikantët e mëparshme që veç është paguar e as një masë nuk është marrë.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit. Ne e kemi një procedurë të cilën e ndjekim jo vetëm ne por e tërë Kosova për trajtimin e qenve endacak. Sot e kam dërguar në prokurim një kontratë të re e cila nuk e bën zgjidhjen përfundimtare por mund të them që kontrata e vitit të kaluar prej 20.000€ e ka arsyetuar vlerën, aktivitetin e punëve dhe për këtë mund të vini ta merrni një raport të punëve të cilat janë realizuar në teren. Drejtori tutje jep sqarime dhe thotë që seancën tjetër do ta sjell raportin.

Laureta Tafaj - ndoshta edhe gjysma e buxhetit të komunës me pas shkuar nuk kishte me qenë shumë, vetëm me eliminuar këtë çështje të qenve endacak por nuk më garanton sepse banojmë këtu afër dhe nuk mund të dalim natën sepse aty ndodhen mbi 20 qen që vërsulen.

Ardian Kotorri - çështja e qenve endacak është problem kombëtar. Në vitin 2023 nuk ka pas kontratë, në vitin 2024 u bërë një kontratë dhe gjendja ka qenë më e mirë.

Laureta Tafaj - do të thotë duhet më shumë 10 persona për me qenë gjendja e keqe e 1 pse ta sulmojnë, gjendja qenka më e mirë! Si një, si dhjetë, është e njëjta.

Ardian Kotorri - tutje jep sqarime.

Laureta Tafaj - drejtor, si e bën dallimin? T'u ka sulmu prap një qytetar prej qenve.

Enver Shabani - nuk e di çka ka dasht me thënë autori me sasinë 1 por nëse flasim për 2500€ të ndara për zjarrëfikësat dhe uniformën e zjarrëfikësve, ju e dini secili nga zjarrëfikësat me kontratë janë punëtor të Ministrisë së Punëve të Brendshme por një barrë që na ka lënë neve është se pagat i marrin nga komuna dhe të gjitha shpenzimet tjera i kryen komuna. Me këto mjete do të blehet uniformë verore duke përfshirë maica, këpucë. Drejtori tutje jep sqarime.

Laureta Tafaj - unë e di që një veshje e zjarrëfikësit duhet me qenë ndoshta mbi 2500€ por këtu sasia po thotë 1 dhe 2500€ për 1 veshje janë pak, për 10 maica janë shumë.

Enver Shabani - jep sqarime sa i përket pyetjes.

Albulena Kokollari - shuma që është parapa për buqeta është për komplet vitin ku komuna e Suharekës i nderon varrezat e dëshmorëve, lapidarët e dëshmorëve në çdo festë zyrtare.

Urim Suka - rëndësia e dokumenteve që na sillni është e madhe dhe mënyra se si po i përgaditni është jo serioze. Mos e merrni si kritikë por merrni si diçka që ju duhet me ndryshu në të ardhmen. Në planin e prokurimit figuron ndërtimi i rrugës “Lagjja e Gashvë” në Krushicë të Poshtme por me miratimin e buxhetit figuron që për vitin 2025 rruga „Liman Ademi“. A do të shtrohet sipas planit që është miratu buxheti apo ka m'u shtrur rruga „Lagjja e Gashvë“ sipas planit të prokurimit? Ose është gabim teknik ose nuk është mirë me ndodh ky ndryshim. Në buxhet është planifiku ndërtimi i impiantit për ujërat e zeza në Sllapuzhan dhe Dubravë nga 100.000€ për secilën por në planin e prokurimit unë nuk i pashë askund që janë të planifikuara. Unë mendoj që ato që janë miratu në buxhet, plani i prokurimit duhet ti ketë dhe pastaj m'u ekzekutu. Në planin e prokurimit po figuron ndërtimi i rrugës “Bashkimi” në Greiqec mirëpo kjo rrugë është e shtruar në vitin 2024. Këto që i ngrija janë vetëm tri shembuj mirëpo ka plot probleme të tilla.

Enver Shabani - për impiantet është e vërtetë. Korniza afatmesme buxhetore ka parapa një buxhet prej 100.000€ për dy impiantet, në Sllapuzhan dhe Dubravë por kjo ka qenë një kontratë e lidhur në vitin 2024 dhe ka qenë kontratë dyvjeqare andaj nuk kemi nevojë me zhvillu procedurat e prokurimit sepse tani e kemi një kontratë dhe është e paraparë në KAB por jo në aktivitet të prokurimit. Sa i përket Krushicës është gabim teknik sepse të dy rrugët do të rregullohen. Sa i përket rrugës „Bashkimi“ ajo është e shtruar vitin e kaluar siç e thashë që janë bërë ndryshime me kërkesë të banorëve të fshatit Greiqec.

Reshat Selimaj - dua të lidhem me Ardianin për çështjen e qenve endacak. Ne si asambleista nuk po dyshojmë që nuk është punu por këto referenca që i kanë në kontratë nuk kanë rezultat. Ne në Greikoc detyrohemi mi dërgu fëmijët në shkollë dhe me i marr sepse janë 40 qen. Mendoj që ju si drejtori dhe gjithë Kosova është mirë me ndërru këtë strategji dhe me gjet një formë tjetër sepse kjo kontratë nuk po jep rezultat.

Ardian Kotorri - ajo që është e paraparë me ligj dhe sipas kontratës që e kemi në fuqi është vetëm trajtimi i qenve, disa aktivitetëve që i kemi në paramasë dhe prap kemi m'i lëshu. Edhe unë pajtohem me ty dhe është mirë të bëhet një zgjidhje rajonale.

Reshat Selimaj - ne si shtet paratë dhe kohën po e hargjojmë por dëmi prap po është ekzistent.

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Alban Berisha - te mirëmbajtja e rrugëve tash e sa vite është i njejtë problem te ato gropa që krijohen prej kushteve atmosferike. Në shumë raste e di që ndërhyhet por janë aq gropa të vogla që nuk ka nevojë me pritë një kontratë, një tender për m'i mbyll ato duke pas parasysh dëmet që shkaktohen në veturat tona. Si ekzekutiv 10 € që i merrni taksë komunale, si ndihesh drejtor kur të kaloni nga ajo gropë? Mos e merr personale sepse po të pyes si drejtor. Shoh që shumë qytetar me vet iniciativë e mbushin atë gropë. Sa i përket komunikacionit kam dëshirë me diskutu kur është edhe Kryetari dhe me pas si pikë të rendit të ditës për shkak që me një raport që e kam pa unë vet, ka denime marramendëse për parkingje nëpër qytet. A e kam të drejtën unë si asambleist me diskutu sepse vërtetë është shqetësuese sepse nuk ekzistojnë parkingje në Suharekë dhe në një formë jemi duke bërë padrejtësi. Drejtor, a je i kënaqur ti personalisht me punimet në shesh?

Enver Shabani - kontratën që e kemi për sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale, është kontratë 2 vjeqare dhe ka vlerë të mirë por nuk është njëburimore por është kontratë që është lidh nëpërmjet zyrës së prokurimit me oferta. Janë disa rrugë që edhe mua më pengojnë por edhe gropat më pengojnë por kemi

rrugë urbane që i menaxhon ministria dhe që i menaxhon komuna. Ne po mudohemi m'i mirëmbajtë por nuk mund ti arrijmë të gjitha. Shumica janë të parapame në kontratë por punët e vogla asnjë firmë e madhe nuk po do t'i kryej. Problemi që kemi brenda është brendapërbrenda edhe me kompaninë dhe nuk po mundemi me i menaxhu sepse nuk mund ti urdhërojmë. Andaj besoj që ndërmarrja komunale që është në themelim e sipër, do ti zgjidh këto probleme të vogla.

Kushtrim Kuçi - prej pandemisë e këndeje, kurrë nuk është mbajtë akademi përkujtimore për 26 mars që është përvjetori i viktimave të luftës dhe kur po kalon 26 marsi nëpër fshatra po bëhen organizime por në Suharekë nuk është mbajtë asnjë akademi përkujtimore për viktimat e luftës dhe besoj duhet ta keni parasysh si komunë.

Kryesuesi - është ide e mirë dhe pse jo, mund të mbajmë akademi përkujtimore.

Kushtrim Kuçi - te biblioteka e qytetit „Hajdin Berisha“ besoj që është mirë dhe e arsyeshme me vendos një bust të Hajdin Berishës dhe mendoj qeverisja lokale e merr parasysh kërkesën.

Flamur Bytyçi - përshëndet të pranishmit. Pse nuk po jepet në shfrytëzim fusha e futbollit në Samadraxhë? sepse ka shkolla të futbollit që janë bë shumë. Fusha i plotëson të gjitha kriteret sepse e ka zhveshtoren, sistemin e ujitjes, rrethojat. Kam informacione që federata i heq 50 % të investimeve në atë pjesë.

Albulena Kokollari - nuk kam informacione që ka bë naj klub kërkesë për shfrytëzimin e palestrës.

Flamur Bytyçi - te plani i prokurimit për vitin 2024, pash projektin për bashkëfinancimin dhe renovimin e urës-tranzit-rregullimi i shtartit të lumit Toplluha, data e skadimit 06.12.2024, vlera e kontratës 331.000€ dhe shpenzimet janë zero. Kërkoj sqarime për këtë sepse nuk e kam të qartë.

Visar Kuçi - është në bashkëfinancim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal. Janë udhëheq procedurat dhe kanë përfunduar por ka qenë lënda në OSHP. Është kthyer lënda prej OSHP-së dhe nëse nuk gaboj është nënshkru kontrata javën e kaluar dhe për këtë nuk është shpenzuar.

Urim Suka - dua ta plotësoj pyetjen e Kushtrimit sepse më duket e keqkuptuar. Pyetja e Kushtrimit ishte që komuna si institucion duhet me pas në listën e aktiviteteve të veta, me parapa akademinë përkujtimore për viktimat civile të 26 marsit. Pyetja ime ka të bëjë me DSHPE. Drejtor jeni në dijeni për ndërtimin e rrugës „Dugagjini“ në Bllacë, kjo rrugë është ndërtuar dhe për një periudhë të shkurt është dëmtuar. Pse nuk është penalizuar dikush që është dëmtuar kaq shpejt? Për deri sa është një kontratë për mirëmbajtje, pse nuk po intervenohet që ajo rrugë me u rregulluar? A ka mundësi që me kontratën për mirëmbajtje, ju të intervenoni dhe ta ktheni në gjendje të mirë atë rrugë?

Nënkryetarja - dhe e kemi pas një takim me kryetarin e ri të shoqatës së veteranëve të UÇK-së ku ishte i pranishëm edhe Kryetari. Biseduam për mnyrën se si do ta zhvillojmë agjendën e përkujtimeve të martirëve të luftës. Komuna gjithmonë në bashkëpunim me shoqatat e dalura nga lufta i bën këto agjenda. Pyetja e Kryetarit ishte që a do të vazhdojmë vetëm homazhe apo do të bëjmë akademi dhe e lanë të marten edhe një takim sëbashku me tri shoqatat e dalura nga lufta dhe do të diskutojmë për formën dhe mënyrën e organizimit e këtyre.

Urim Suka - e dimë pjesën e shoqatave të dalura nga lufta për këto organizime nëpër fshatra. Ne po flasim për organizime në nivel institucional, p.sh. 13 Qershori është dita e qllimit dhe dita e dëshmorëve dhe 26 Marsi është dita e martirëve dhe unë po mendoj që këto dy data institucionalisht duhet m'u rrespektu.

Avni Bytyqi - vendimi ekziston ku Kuvendi i Komunës ka marrë vendim që 13 Qershori, dita e çlirimit të Komunës të jetë edhe dita e nderimit të dëshmorëve dhe të gjithë atyre që kanë dhënë jetën për këtë vend. Për 26 marsin nuk ka vendim.

Kryesuesi - ka qenë kërkesë e OVL UÇK-së që të jetë një datë dhe në bazë të kërkesës së tyre është nxerr ky vendim.

Enver Shabani - rruga „Dugagjini“ që është shtruar para disa viteve në Bllacë, i kemi mundësitë me riparuar atë rrugë dhe besoj me një renditje që kemi me bë kanë me përfunduar të gjitha ku ka nevojë të intervenohet

Shefket Kolgeci - unë dhe qytetarët e fshatit Vraniq jemi të brengosur për shkollën në Vraniq sepse 7 vite janë bë dhe ende nuk është ndërtuar. A do të ndërtohet këtë vit apo jo shkolla në Vraniq?

Nënkryetarja - gjendjen e kam pa dhe është e tmerrshme dhe e rrezikshme por nuk kam informatë të saktë.

Laureta Tafaj - Lapidari i dëshmorit Nysret Gashi tek rrethi në rrugën „Skënderbeu“ kur ka me

u përfundu? pasi data e rënies po vjen së shpejti dhe është heq prej vendit ku ka qenë.

Visar Kuçi - Lapidari i dëshmorit Nysrte Gashi përfundon kur të përfundon rruga Skënderbeu dhe për afat nuk mund të tregojmë saktë.

Laureta Tafaj - më ka rastësisë me 14 shkurt, të ashtuquajturën dita e Shën Valentinit, në sheshin „Fadil Vata“ kam pa që sheshi ka qenë i zbukuruar me disa balona në formë zemre por shpresoj nuk i ka bërë Komuna.

Albulena Kokollari - jo nuk kam informacion dhe nuk i paskam pa edhe vet.

Takimi përfundoi: 12:30

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj